



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2019:236326

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05407416

P.nr.483/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Dega në Viti-Departamenti i Përgjithshëm përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Naser Maliqi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Shqipe Kastrati, në çështjen penale kundër të pandehurit I.Z, nga fshati, Komuna e Vitisë, për shkak të veprës penale asgjësimi, dëmtimi apo heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës, nga neni 358 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 5 dhe 3 të KPRK, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.1471/2019 të datës 15.10.2019 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të datës 29.02.2024 në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, i dëmtuari Z.B dhe i pandehuri I.Z, mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 04.03.2024 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri I.Z, nga babai A dhe nëna N, e lindur A, i lindur me datënë fshatin, Komuna e Vitisë, ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i tre fëmijëve, i pa punësuar, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 11.07.2019 rreth orës 16:30 në fshatin, Komuna e Vitisë i pandehuri nga pakujdesia nuk i ka instaluar pajisjet mbrojtëse në vendin e punës në atë mënyrë që i pandehuri kishte filluar ta ndërtoj një shtallë-pleme për bagëti dhe derisa i dëmtuari ishte duke punuar në stallë i cili ishte duke i renditur tjegullat e kulmit përnjëherë shembet kulmi i stallës dhe disa mure të stallës ku i dëmtuari rrëzohet nga kulmi dhe bie në dyshme ku edhe pëson lëndime të rënda trupore i cili për shkak të lëndimit kërkon ndihmë mjekësore në QKUK në Prishtinë,

-Me çka ka kryer veprën penale asgjësimi, dëmtimi apo heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës, nga neni 358 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 5 dhe 3 të KPRK,

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 38, 81 dhe 82 të KPRK-së si dhe nenit 498 dhe 499 të KPP-së të pandehurit të lartcekur i shqipton :

VËREJTJE GJYQËSORE

Ashtu që të pandehurit I.Z i bëhet me dije se ka kryer veprë të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën veprë penale dhe nëse ai sërish kryen veprë të tillë gjykata do t'i shqiptojë një sanksion më të rëndë penal.

Gjykata nuk vendosi lidhur me kërkesën pasurore juridike meqenëse i dëmtuari Z.B në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 29.02.2024 ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale ndaj të pandehurit si dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që të paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të kimit, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 15.10.2019 ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.1471/2019, kundër të pandehurit I.Z, nga fshati ..., Komuna e Vitisë, për shkak të veprës penale asgjësimi, dëmtimi apo heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës, nga neni 358 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 5 dhe 3 të KPRK.

Më datë 14.09.2021 në këtë gjykatë është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën kanë prezantuar prokurori i shtetit dhe i pandehuri I.Z, në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar plotësisht aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe nuk e pranon fajësinë për kryerjen e saj, me ç' rast gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 243 dhe 244 të KPP, e ka njoftuar të pandehurin se mund të paraqesin kundërshtim për provat e cekura në aktakuzë dhe të paraqesin kërkesë për huthjen e aktakuzës.

Me krijimin e kushteve ligjore gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me datën 29.02.2024 në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, i dëmtuari Z.B dhe i pandehuri I.Z, në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar plotësisht aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e saj me ç' rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 322 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

Dhe në këtë seancë pasi që i pandehuri i lartcekur e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar gjykata nuk e ka bërë administrimin e provave personale dhe materiale dhe palët kanë dhënë fjalët e tyre përfundimtare.

Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë dhe i ka propozuar gjykatës që gjatë marrjes së vendimit ti ketë parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

I dëmtuari Z.B në fjalën përfundimtare ka deklaruar nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi.

I pandehuri i lartcekur në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i vjen keq për rastin që ka ndodhur dhe ka premtuar që në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin dhe nuk do të përsëris veprën penale.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata në seancën e shqyrtimit gjyqësor pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 322 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: raporti fillestari i incidentit me numer të rastit 2019-CG-279 i datës 09.09.2019, deklarata e të dëmtuari, dëshmitarit, të pandehurit, raporti i inspektoratit, foto dokumentacioni, raporti mjekësor në emër të të dëmtuarit, ekspertiza mjekësore, ku për të dëmtuarin konstatohet lëndim i rëndë trupor, raporti i policit, si dhe shkresat e tjera në lëndë. Po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: i pandehuri i lartcekur e ka kryer veprën penale asgjësimi, dëmtimi apo heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës, nga neni 358 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 5 dhe 3 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të vërejtjes gjyqësore

Gjykata me rastin e shqiptimit të vërejtjes gjyqësore pati parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ngase kjo vërejtje gjyqësore e shqiptuar ndaj të pandehurit është në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e shqiptimit të vërejtjes gjyqësore mori parasysh rrethanat personale të të pandehurit sjelljen e tij në gjykatë, e gjithashtu si rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata mori faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, i njëjti është penduar dhe kanë shfaqur keqardhje për veprimet e tij, ka kërkuar falje për këto veprime, faktin se i njëjti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepër të tilla dhe as vepra të tjera penale, faktin se kjo ishte hera e parë që të njëjtit bien ndesh me ligjin, përkatësisht më parë nuk kanë qenë i gjykuar e as dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale, ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata mori rrezikshmërinë e veprës penale sepse nga përshkrimi faktik si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës është konstatuar se i dëmtuari është rrezuar nga kulmi ku edhe ka pësuar lëndime të rënda trupore andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata të pandehurit i shqiptoj vërejtje gjyqësore, duke konsideruar se këtë vërejtje gjyqësore të shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës, të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Gjykata me rastin e shqiptimit të vërejtjes gjyqësore gjithashtu pati parasysh se të pandehurit

të lartcekur, i bëhet me dije se ka kryer veprë të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën veprë penale dhe nëse ai sërish kryen veprë të tillë gjykata do t'i shqiptojë një sanksion më të rëndë penal.

Gjykata nuk vendosi lidhur me kërkesën pasurore juridike meqenëse i dëmtuari Z.B në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 29.02.2024 ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale ndaj të pandehurit si dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

6.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit si dhe bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta detyroj të paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro), si dhe shumën prej nga 30 € (tridhjetë euro), për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.483/2019 me datë 04.03.2024

Bashkëpunëtorja profesionale,
Shqipe Kastrati

Gjyqtari i vetëm gjykues
Naser Maliqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate themelore.